



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 131/6 Prot.

Tiranë, më 13 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 45, Datë 13 . 02 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 176 Regj., datë 22.09.2023, të subjektit ankues, Fondacionit “Së Bashku”, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Shkodër, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”, të personave me aftësi të kufizuar, lidhur me mungësen e aksesueshmërisë në ambientet e këtij Institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e hasur prej tyre, duke parashtruar se, ndërtesa e Institucionit të DRSHSSH Shkodër nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që i vë ata në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët, në respektim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

¹ Referuar dokumentacionit respektiv, Fondacioni “Së Bashku” mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK, përfshirë dhe personat që janë përdorues të karriges me rrota, për shkak të aftësisë së kufizuar apo paaftësisë lëvizëse të tyre).

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Përmirësimin e situatës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, nga ana e DRSHSSH Shkodër”*.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Bazuar në ankesën e paraqitur, Fondacioni “Së Bashku” pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara lidhur me mohimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), në ambientet e DRSHSSH Shkodër, për shkak të mungesës së rampës.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore të aktit normativ, VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”, nëpërmjet të cilave PAK janë përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e DRSHSSH Shkodër.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet:

“1. Komisioneri ka kompetencë: ...b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”.

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet se:

“Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se:

“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“Palë” është:

- a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;
- b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative;
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”

Bazuar në nenin 33, pika 3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezultojnë se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t'u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së Fondacionit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur.

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Fondacioni “Së bashku”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, në kuadër të përfaqësimit të interesave të gjithë grupit të personave me AK, me status tetraplegjiku, të cilët janë përftues të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1027/1 prot., datë 26.09.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Shkodër, lidhur me pretendimet e ngritura për çështjen në fjalë.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 2713 prot., datë 09.10.2023, DRSHSSH Shkodër, ka dërguar pranë Komisionerit parashtrimet lidhur me qëndrimin për sa i takon çështjes në fjalë, duke cituar si më poshtë:

“...lidhur me mungesën e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar (PAK) në ambientet e DRSSSH Shkodër, theksojmë se mungesa e rampës është një nga problematikat që është ngritur edhe nga ana e Drejtorisë tonë.

DRSHSSH Shkodër, duke qenë se ushtron aktivitetin e vet në ambiente të marra me qira për ndërhyrje në infrastrukturën e objektit, mjediset e tij dhe territorit përreth, qofshin këto përshatje apo shtesa, duhet të marrë miratimin me shkrim nga subjekti qiradhënës.

Bazuar në kërkesën me nr. 79 prot., datë 10.05.2022, të Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër, Drejtoria jonë i është drejtuar me shkresë² subjektit qiradhënës, që në një nga hyrjet e ambienteve të dhëna me qira për zyra, të ndërtohet një platformë e pjerrët (rampë) duke krijuar akses për personat me aftësi të kufizuar.

Subjekti qiradhënës ka kërkuar takim me drejtuesin e institucionit dhe gjatë takimit të realizuar nuk ka dhënë dakordësinë e tij, pasi kjo nuk është e mundur nga ana teknike.

Kontrata e institucionit tonë me subjektin qiradhënës, bazuar në Kontratën e qirasë me nr. Rep. 16 dhe Nr. Kol. 16, datë 04.01.2023, është e vlefshme deri më datë 31.12.2023, ndërkohë që pritet ndryshimi i ambienteve të DRSHSSH Shkodër, qofshin këto ambiente shtetërore apo private.

Lidhur me praktikën e ndjekur për ofrimin e mundësisë për akses në ambientet e institucionit, theksojmë se, DRSHSSH Shkodër, ka në fokus të punës së saj t’i shërbejë çdo qytetari, dhe deri tani nuk besojmë se ka munguar ofrimi i shërbimeve nga ana e institucionit tone për çdo qytetar i cili ka kërkuar të marrë informacione apo dhe ankesa lidhur me asistencën sociale.

² Shkresa me nr. 1421/1 prot., datë 20.05.2022, e DRSHSSH Shkodër.

Infrastruktura nuk ka qenë asnjëherë arsye për të cilën punonjësit e institucionit tonë të mos ofrojnë shërbimin e çdo qytetari që ka kërkuar të marrë shërbime nga Drejtoria jonë.

Gjithashtu, në kuadër të reformës së decentralizimit dhe ofrimit të shërbimeve sa më pranë qytetarëve, shërbimet për personat përfitues të statusit të paraplegjikut dhe tetraplegjikut dhe statusit të të verbërit, ofrohen pranë vendbanimit të tyre nga Administratorit Shoqëror, të tilla si: dorëzimi i dokumentacionit për vlerësim, rivlerësim, datën e intervistës, komunikimin e vendimit të KMCAP/KMPV, ankimit, etj.”

2. Komisioneri, në respektim të parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet e-mailit të datës 10.10.2023, njohu palën ankuese lidhur me përgjigjen dhe aktet e depozituara nga DRSHSSH Shkodër.
3. Në përgjigje të këtij e-maili, përfaqësuesja e subjektit ankues, Fondacionit “Së Bashku”, i është drejtuar Komisionerit, me e-mailin e datës 16.10.2023, si më poshtë vijon:

“I lexova me kujdes dokumentet dhe po tërhiqemi nga ankesa me këto kushte:

- *Duke qenë se kontrata e qirasë përfundon në fund të vitit 2023, nëse një vend tjetër për vitin e ardhshëm duhet të merret me qira, duhet të jetë në përputhje me të gjitha standardet e aksesueshmërisë;*
- *Ose, zyrat përfundimtare duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, sepse kjo është një kërkesë ligjore.”*

Në lidhje sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në Kontratën e Qirasë së lidhur mes DRSHSSH Shkodër dhe subjektit privat qiradhënës, evidenton faktin se efektet juridike të saj shrihen për periudhën kohore nga data 04.01.2023 deri më datë 31.12.2023. Për rrjedhojë, deri në përfundim të kësaj kontate nuk mund të bëhet asnjë ndërhyrje nga ana teknike lidhur me sigurimin e aksesueshmërisë për PAK në ambientet e godinës ku insitucioni ushtron veprimtarinë aktualisht.

4. Për sa më sipër, në kushtet kur për këtë çështje pritet që të merren masat konkrete, në përmbushje të kriterëve të aksesueshmërisë për PAK, lidhur me godinën e re ku DRSHSSH Shkodër do të ushtrojë aktivitetin, brenda muajit janar 2024, si dhe në mbështetje të nenit 85, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet se: “Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Vendimin e tij me nr. 231, datë 09.11.2023, pezulloi shqyrtimin e çështjes të mungesës

së aksesueshmërisë së ambienteve të DRSHSSH Shkodër³, deri në muajin janar 2024, që Drejtoria të akomodohet në ambientet e reja, qofshin ato shtetërore apo private.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në zbatim të kompetencave ligjore, i rekomandoi DRSHSSH Shkodër që, lidhur me gjetjen e ambienteve ku Drejtoria do të ushtrojë veprimtarinë e saj, (brenda muajit janar 2024) të ketë në konsideratë që ato (qofshin ambiente shtetërore apo private) duhet të përmbushin kriteret ligjore lidhur me aksesueshmërinë e PAK, në respektim të kërkesave të ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*.

5. Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 131 prot., datë 23.01.2024, iu drejtua sërish DRSHSSH Shkodër, duke kërkuar prej saj informacion dhe kopje të akteve përkatëse, (Kontratës së qirasë, foto ambientale të elementëve të aksesueshmërisë apo akteve teknike të specialistëve të fushës, të konstatimit nga ana e tyre, se përmbushen elementët e kriteret ligjore për aksesueshmërinë e PAK, konform parashikimeve të VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”*, etj) apo hapave e masave konkrete të ndërmarra, me anë të të cilave provohet se godina (shtetërore apo private) aktuale e DRSHSSH Shkodër, përmbush të gjitha kriteret ligjore të aksesueshmërisë për PAK.

6. Në përgjigje sa më sipër, DRSHSSH Shkodër, me shkresën nr. 283 prot., datë 31.01.2024, informoi Komisionerin se:

“Gjatë kërkimit të ambienteve në të cilat DRSHSSH Shkodër mund të ushtrojë aktivitetin e saj dhe të cilat plotësojnë kriterin e aksesueshmërisë për PAK, rezulton se institucionet shtetërore nuk kanë asete të lira, të cilat mund të vendosen në dispozicion të Drejtorisë tonë.”

Me datë 29.01.2024 DRSHSSH Shkodër nënshkruan kontratën me nr. 453 Rep., dhe nr. 280 Kol., me subjektin qiradhënës Luani sh. p. k, me kushtin: *“Qiradhënësi duhet të garantojë dhe sigurojë aksesueshmëri në ambientet e zyrave, akese për PAK, në një nga hyrjet e godinës, duke përmbushur standardet dhe kriteret teknike të përcaktuara në VKM nr. 1503/2008 “Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e PAK”, si dhe “...Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga qiramarrësi, duke njoftuar qiradhënësin 30 ditë përpara zgjidhjes së Kontratës, në rast se, gjatë periudhës së kontraktuar gjendet një objekt shtetëror ose një objekt tjetër privat me qira më të ulët.”*

DRSHSSH Shkodër, ka dërguar bashkëlidhur përgjigjes, korrespondencën shkresore të mbajtur me 35 institucione shtetërore, për kërkimin e ambienteve shtetërore për akomodimin e tyre,

³ Ankesës me nr. 176 regj., datë 22.09.2023.

kopjen e kontratës së qirasë me subjektin privat, si dhe ka informuar se në ditët në vijim do të dërgojë edhe foto të rampës së përfunduar, pasi ishte duke u punuar akoma për realizimin e saj.

7. Me shkresën me nr. 283/1 prot., datë 06.02.2024⁴, DRSHSSH Shkodër ka informuar KMD-në se: “Subjekti qiradhënës, në zbatim të detyrimeve kontraktuale të Kontratës së Qirasë me nr. 453 Rep., dhe nr. 280 Kol., datë 29.01.2024, ka proceduar me ndërtimin e rampës në një nga hyrjet e godinës, duke siguruar aksesueshmëri për PAK, si dhe ka bashkëlidhur fotot e rampës.
8. Në këto kushte, duke qenë se nga ana e DRSHSSH Shkodër u përcoll informacioni i kërkuar si dhe referuar faktit që përfundoi afati i caktuar për kthimin përgjigjes në vendimin e ndërmjetëm, Komisioneri, me Vendimin nr. 40, datë 13.02.2024, vendosi ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës së shqyrtimit të ankesës.
9. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit dhe transparencës, Fondacionit “Së Bashku”, i është përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 08.02.2024, dokumentacioni dhe fotot e dërguara nga DRSHSSH Shkodër, lidhur me ndërtimin e rampës për aksesueshmërinë e PAK në ambientet e këtij institucioni.
10. Pasi është njohur me dokumentin sipërcituar, përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku”, znj. L, nëpërmjet emailit të dërguar po me datë 08.02.2024, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar reagimin e DRSHSSHsë dhe masat e ndërmarra prej saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për sigurimin e aksesueshmërisë për PAK në ambientet e këtij institucioni, në zbatim të kriterëve teknike të përcaktuara në VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

⁴ Administruar pranë KMD-së me nr. 131/2 prot., datë 08.02.2024.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 176 Regj., datë 22.09.2023, të Fondacionit “Së Bashku”, kundër DRSHSSH Shkodër, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. DRSHSSH Shkodër, nëse në të ardhmen, do ndryshojë godinë (qoftë shtetërore apo private), të ketë në konsideratë plotësimin e zbatimin e kritereve të aksesueshmërisë, sipas VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

